

PROCEDURA QE NDIQET NE RAST TE NDODHJES SE DEMIT

INFORMACION I PERGJITHSHEM

Nëse jeni siguruar prane INSIG JETE sha, dhe;

- jeni aksidentuar,
- keni marrë shërbime mjekësore Brenda vendit, si pasojë e një sëmundje apo aksidenti brenda ose jashtë rrjetit mjekësor te INSIG JETE sha.
- keni marrë shërbime mjekësore si pasojë e një sëmundje apo aksidenti gjatë qëndrimit në një vend të huaj,

Informohuni mbi procedurat që duhen ndjekur për të raportuar dëmin që keni pësuar:

HAPJA E PRAKTIKAVE TE DEMEVE

Njoftimi i rastit të ngjarjes se sigurimit behet sipas formularit përkatës dhe behet:

- me shkresë,
- në mënyrë elektronike ne faqen e INSIG JETE sha apo dhe me
- telefon në Degë ose Zyrat Qendrore te Kompanise.

Praktika e demit hapet në momentin e njoftimit te rastit të sigurimit nga:

- policmbajtësi,
- përfituesi, apo
- i siguruari.

AFATI I SHQYRTIMIT TE PRAKTIKES SE DEMIT

Praktika e demit shqyrtohet brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të dokumentit të fundit nga përfituesi, apo i siguruari.

Ky afat shtyhet deri në dorëzimin e dokumentit shtese të fundit te kërkuar nga shoqëria e sigurimit;

Periudha e trajtimit të rastit të sigurimit do të jetë e ndryshme nëse kjo gjë është parashikuar në kushtet e kontratës së sigurimit.

Afati i shqyrtimit te praktikës shtyhet deri ne vërtetimin e shkaqeve apo nxjerrjes se paaftësisë për rastet e:

- e paaftësisë së përhershme, kur nuk është e mundur të përcaktohet brenda një kohe të shkurtër shkalla e paaftësisë;
- vdekjes, kur rrethanat e ndodhjes së demit janë të paqarta dhe kërkojnë një periudhë të gjatë për tu vërtetuar nga organet kompetente.

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHEM PER PLOTESIMIN E PRAKTIKAVE TE DEMEVE

Njoftimi i rastit të sigurimit sipas formularit përkatës.

Polica e Sigurimit ose certifikata e sigurimit (origjinale ne rast vdekje).

Mandat arkëtimi, konfirmimi bankar ose urdhër xhirimi i primit/primeve të arkëtuara.

Dokumentacioni mjekësor (epikriza mjeksore, kopje te karteles mjeksore, etj) sipas rastit te sigurimit qe mbulon polica e sigurimit;

Dokumentacioni nga organet e policisë dhe ato te drejtësisë (gjykate; prokurori) sipas rastit te sigurimit;

Skeda e vdekjes dhe certifikata e vdekjes (kur i siguruara ka humbur jeten)

Çdo dokument tjetër sipas polices se sigurimit dhe të kërkuar nga INSIG JETE SH.A.